



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.161/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur ndaj Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), për shkak të mos hapjes së zarfeve, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në Raundin e II (dytë) për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 31.05.2012, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 30.05.2012, nga subjekti politik LDK, në të cilën pretendohet se në QNR në Fushë Kosovë, nga 617 zarfe gjithsej, 126 zarfe prej tyre nuk janë hapur fare me arsyetimin se janë të pavlefshëm. Parashtruesi i ankesës thekson se duke u nisur nga ky fakt, kërkon që të merret vendim që QNR-ja, të bëjë hapjen e zarfeve, në mënyrë që të evidentohen personat që kanë votuar.

PZAP pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës pretendon se nuk janë hapur 126 zarfe nga gjithsejtë 617 sa ishin në tërësi, për ti evidentuar se a janë të vlefshme apo të pavlefshme fletëvotimet që gjenden në zarfet e lartpërmendura, dhe më këtë rast parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të ndërmerren masat për evitimin e shkeljes së pretenduar. PZAP-i, konstatoi se ankesa nuk i përmbush kriteret e parapara në nenin 3 paragrafi 6 pika “b” e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ngase në ankesë nuk është bërë një përshkrim i hollësishëm duke përfshirë datën kohën e shkeljes së supozuar. Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës për ti bërë pretendimet e tij bindëse apo eventualisht që PZAP-i të merr ndonjë vendim tjetër lidhur me rastin konkret, andaj konform nenit 118 paragrafi 1, nenit 105 paragrafi 1 si lidhur me nenin 115.1 të LZP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 161/2012 më datën 31.05.2012.

